

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Shpjegimi dhe komentimi i
“AJETIT KURSI”

Tiranë, 2026

Titulli: **Shpjegimi dhe komentimi i “Ajetit Kursi”**

Autori: **Imam Sejid Ali Khamenei** (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*)

E përktheu nga arabishtja: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

E redaktoi: Jerida **KULLA**

E korrekttoi: **Ma. Isra MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata “Flladi”** - Tiranë, 2026

Marrë nga: <https://books.almaaref.org>

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!

HYRJE

Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi, ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: ‘O Ali! Ka zbritur një ajet nga thesaret e Arshit dhe, me zbritjen e tij, çdo idhull që adhurohej në lindje e në perëndim, u rrëzua me fytyrë përtokë’.

Iblisi u tmerrua dhe tha: ‘Sonte ka ndodhur një ngjarje shumë e madhe. Më jepni afat që të shkoj në lindje e në perëndim të tokës për ta kuptuar se çfarë ka ndodhur’.

Ai shkoi në Jethrib (Medinë), ku takoi një njeri. Iu shfaq në pamjen e një plaku dhe i tha: ‘O rob i Allahut! A ka ndodhur sonte, apo do të ndodhë sot, ndonjë ngjarje e veçantë?’

Njeriu iu përgjigj: 'Po. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) na ka njoftuar se i ka zbritur një ajet dhe se çdo idhull është rrëzuar me fytyrë përtokë'.

Atëherë Iblisi u kthye te shokët e tij dhe tha: 'Ngjarja më e madhe ka ndodhur në Jethrib'.

Më pas, kur shkuan në Medinë dhe hetuan çështjen, mësuan se kishte zbritur Ajeti Kursi.

Ajeti Kursi, i cili, me zbritjen e tij, bëri që çdo idhull në botë të rrëzohej me fytyrë përtokë, zë një vend të veçantë në mësimet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Ehli Bejtit të tij. Për vlerën e tij të jashtëzakonshme dhe rëndësinë e vazhdimësisë së leximit të tij janë transmetuar shumë hadithe.

Në një hadith, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha Ali ibn Ebu Talibit: "O Ali! Përmbaju leximit të Ajetit Kursi pas çdo namazi farz, sepse në këtë vepër nuk këmbëngul veçse një profet, një besnik i sinqertë ose një dëshmor".

Në një transmetim tjetër, ai ka thënë: "Kush e lexon Ajetin Kursi pas çdo namazi farz, Allahu i Madhëruar do t'ia marrë Vetë shpirtin e tij dhe ai do të jetë si ai që ka luftuar përkrah profetëve, derisa të ketë rënë dëshmor".

Gjithashtu, ai ka thënë: "Kush e lexon Ajetin Kursi pas çdo namazi të detyrueshëm, asgjë nuk do ta pengojë nga hyrja në Xhenet, përveç vdekjes".

Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "Sikur ta dinit se çfarë përmban Ajeti Kursi, nuk do ta linit kurrë pa e lexuar, në asnjë gjendje".

Përveç ndikimeve shpirtërore dhe shpërblimeve të Botës Tjetër, në hadithe janë përmendur edhe shumë dobi të tij në jetën e kësaj bote, si: ruajtja e pasurisë, largimi i varfërisë, mbrojtja nga e keqja e armiqve, shërimi i sëmundjeve, largimi i xhinëve, plotësimi i nevojave, siguria gjatë udhëtimeve, lirimi nga burgu, krijimi i dashurisë ndërmjet njerëzve dhe shumë të tjera. Natyrisht, për secilën prej këtyre ndikimeve janë përmendur mënyra të veçanta të leximit të Ajetit Kursi, si për nga numri i përsëritjeve, ashtu edhe për nga forma e recitimit.

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në një hadith e ka quajtur Ajetin Kursi "Zonja e ajeteve të Kur'anit". Ky përshkrim tregon qartë pozitën e tij të lartë dhe të veçantë ndërmjet ajeteve kuranore.

Nga ana tjetër, Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "Nuk ka mirësi në një lexim që nuk shoqërohet me meditim".

Prandaj, ky numër i madh rekomandimesh për leximin e Ajetit Kursi duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me meditim të thellë dhe kuptim të drejtë. Mjafton të vështrohen konceptet dhe njohuritë që përmban ky ajet, për të kuptuar se ai është një nga ajetet më madhështore doktrinare të Kur'anit. Meditimi mbi të zbulon dimensione të rëndësishme të teuhidit (Njëshmërisë së Allahut). Sa e nevojshme është që parimet dhe bazat e besimit tonë t'i nxjerrim nga vetë Kur'ani!

Është e njohur se Sejid Ali Khamenei, i konsideruar si një shembull i meditimit mbi Kur'anin dhe i përkushtuar ndaj leximit të tij, i ka theksuar vazhdimisht këto dy çështje në ligjëratat dhe studimet e tij kur'anore. Siç shihet edhe në fotografinë e mësipërme, ai vendos dorën mbi sy pas çdo namazi dhe e reciton Ajetin Kursi me zë të ulët.

Në hadithe është transmetuar se, për mbrojtjen e shikimit, njeriu duhet së pari të thotë: "E mbroj dritën e shikimit tim me dritën e Allahut që nuk shuhet", pastaj të kalojë dorën mbi sy dhe të lexojë Ajetin Kursi.

Para fitores së Revolucionit Islamik, në një nga tubimet e tij kur'anore, Sejid Ali Khamenei, një prej ligjëratave të tij, ia kushtoi pikërisht Ajetit Kursi. Ky libërth e çon lexuesin në atmosferën e atij tubimi, ku merrnin pjesë njerëz të moshave, shtresave dhe kategorive të ndryshme shoqërore.

Ligjërata është mbajtur në xhaminë "El-Kerame" në qytetin e shenjtë të Mashadit, më 31 janar 1974. Në atë periudhë, ai organizonte çdo të premte në mbërëmje tubime kur'anore në xhami. Kjo ligjëratë u mbajt në natën e dytë të së premtes së muajit Muharrem të vitit 1394 hixhri.

Hirësia e tij, i cili zakonisht i mbante ligjëratat pas namazeve të akshamit dhe jacisë, në këmbë dhe me ndihmën e tabelës, u përqendrua në shpjegimin e Ajetit Kursi dhe në nxjerrjen prej tij të temave themelore të akides islame. Ai i paraqiti këto tema me një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme për njerëzit e zakonshëm.

Në shpjegimin e këtij ajeti, ai ndoqi të njëjtën metodë që kishte përvetësuar në komentimin e ajeteve të Kur'anit: e trajtonte ajetin nga një këndvështrim shoqëror dhe e analizonte atë në formën e një studimi me karakter udhëzues dhe edukativ.

Duhet theksuar se kjo ligjëratë ishte e shkurtër dhe, natyrisht, qëllimi i saj nuk ishte shqyrtimi i të gjitha dimensioneve të ajetit. Për këtë arsye, ajo nuk mund të konsiderohet një "tefsir" (komentim i plotë) i Ajetit Kursi. Prandaj, e kemi parë të arsyeshme ta emërtojmë "Shpjegimi dhe komentimi i Ajetit Kursi", një titull që e pasqyron më saktë natyrën e kësaj ligjërate.

Imam Sejid Ali Khamenei, në shtjellimin e parimeve doktrinare të këtij ajeti, është mbështetur në dy parime

themelore, të cilat më vonë i trajtoi gjerësisht edhe në kuadër të sesioneve të tij të njohura si “Projekti i Mendimit Islam në Kur’an”. Sipas tij, besimi i vërtetë dhe i vlefshëm duhet të mbështetet në dy shtylla: ndërgjegjësimin dhe angazhimin.

Në këtë këndvështrim, ai e nxjerr parimin e teuhidit (Njëshmërisë së Allahut) nga Ajeti Kursi duke e shqyrtuar nga dy aspekte. Nga njëra anë, teuhidi është rezultat i vetëdijes, njohjes dhe perceptimit të thellë e të qartë; ndërsa, nga ana tjetër, ai është burim i përkushtimit, përgjegjësisë dhe ndjenjës së detyrës.

Në atë periudhë, besimet e shumë njerëzve të zakonshëm ishin sipërfaqësore dhe të dobëta. Shumë prej tyre pranonin idhujt dhe “zotat” e rremë, ose të paktën nuk guxonin ta shprehnin hapur besimin e tyre në fjalën “La ilahe il’allah” dhe ta zbatonin atë në praktikë. Megjithatë, në një atmosferë të tillë, Sejid Ali Khamenei vepronte me vendosmëri dhe guxim, duke paraqitur hapur mesazhin e teuhidit.

Për shembull, në sesionet e “Projektit të Mendimit Islam në Kur’an”, ai shprehet: “Teuhidi islam formëson sistemin e qeverisjes dhe marrëdhëniet shoqërore, drejton lëvizjen e historisë dhe përcakton synimin e saj. Ai përcakton përgjegjësitë e njeriut ndaj Allahut, ndaj njerëzve të tjerë, ndaj shoqërisë dhe ndaj të gjitha dukurive të natyrës... ky është teuhidi.

Teuhidi islam është si një alfabet që fillon me shkronjën 'A' dhe vazhdon deri te shkronja e fundit. Ai nuk kufizohet vetëm në pohimin se Allahu është Një dhe jo dy. Teuhid do të thotë të pranosh se e drejta absolute për të sunduar mbi jetën tonë individuale dhe shoqërore i takon vetëm Allahut".

Po, baza doktrinare mbi të cilën mbështetet mendimi i Sejid Ali Khameneit janë vetë ajetet e Kur'anit, e në veçanti Ajeti Kursi. Duke u mbështetur në këto themele, ai, përmes fjalimeve, thirrjeve dhe ligjëratave të tij historike, sfidoi strukturat e padrejtësisë dhe "zotat" e rremë të devijimit.

Ashtu siç zbritja e Ajetit Kursi bëri që idhujt të rrëzoheshin dhe mbolli frikë në zemrën e Iblisit, edhe udhëheqësi i Revolucionit Islamik, i frymëzuar nga ky ajet dhe si një ndjekës i sinqertë i shkollës kur'anore, u përball me idhujt e kohës së tij dhe tronditi themelet e sistemeve të padrejtësisë dhe arrogancës.

Megjithëse temat e trajtuara në këtë libërth përputhen në masë të madhe me studimet mbi teuhidin të paraqitura në sesionet e "Projektit të Mendimit Islam në Kur'an", vizioni bashkëkohor, praktik dhe i veçantë që Sejid Ali Khamenei paraqet në lidhje me Ajetin Kursi ka bërë që kjo ligjëratë të botohet dhe të paraqitet si një vepër më vete.

Dhjetor 2014
Sahba

Programi ynë në këtë natë, ashtu siç jemi mësuar në netët e së premtes, përfshin leximin e Kur'anit dhe shpjegimin e disa ajeteve të përzgjedhura. Ajeti që u lexua sonte dhe që ju e dëgjuat, është pikërisht Ajeti i njohur Kursi.

Dëshiroj të sqaroj një çështje, që të bëhet e qartë arsyeja pse sonte e vendosëm leximin e Kur'anit para shpjegimit dhe përkthimit të tij, ndonëse kjo bie ndesh me metodën tonë të zakonshme. Ne zakonisht e fillojmë programin me një hyrje dhe shpjegim, ndërsa leximi i Kur'anit vjen më pas; pra, fjala jonë shërben si hyrje për leximin e Kur'anit dhe jo anasjelltas.

Arsyeja është se në këto net, zakonisht, lexojmë pjesë dhe ngjarje nga tragjedia e Kerbelasë dhe përkujtojmë ato fatkeqësi të dhimbshme. Pas kësaj, shpesh nuk mbetet më gjallëria dhe përqendrimi i nevojshëm për leximin dhe dëgjimin e Kur'anit.

Për këtë arsye, e kemi parë të arsyeshme që, në shenjë respekti ndaj Kur'anit, leximin e tij ta vendosim në fillim të programit.

Nën çfarë titulli e kemi njohur deri më sot Ajetin Kursi, ne dhe të dashurit tanë?

Ne e kemi mësuar dhe e kemi lexuar Ajetin Kursi për mbrojtjen e shtëpive tona, të vendeve tona të punës dhe të

pasurisë sonë; për ruajtjen e jetëve tona dhe të fëmijëve tanë. Gjithashtu, ai është përfshirë në disa namaze dhe veprime të rekomanduara në ditë të caktuara, ndaj ne e lexojmë një herë, dhjetë herë ose njëqind herë, sipas rastit.

Megjithatë, Ajeti Kursi është një ajet i Kur'anit, dhe Kur'ani, në të gjitha ajetet e tij, përmban çështjet më të rëndësishme që njeriu mund të marrë si udhëzim për mendimin dhe jetën e tij.

Por a jemi ne në gjendje t'i kuptojmë saktësisht të vërtetat që përmban Ajeti Kursi apo çdo ajet tjetër i Kur'anit?

Kjo varet nga niveli i dijes sonë, nga studimi dhe vëmendja që u kushtojmë ajeteve kur'anore, si dhe nga shkalla e kuptimit që kemi arritur.

Nëse nuk arrijmë t'i kuptojmë këto të vërteta, kjo nuk është për shkak të mangësisë së ajetit, por për shkak të kufizimeve tona. Vetë ajeti është i mbushur me kuptime dhe njohuri të thella.

Meqenëse sonte nuk kam ndërmend të ndalem në sqarimin e të gjitha njohurive që përmbajnë këto tri ajete të shenjta, të cilat së bashku njihen si Ajeti Kursi, sepse metoda jonë është kryesisht përkthimi dhe shpjegimi i drejtpërdrejtë, do të mjaftohem me përkthimin e tyre.

Megjithatë, do të vini re se edhe vetë përkthimi i këtyre ajeteve na vendos përballë një pasurie të madhe njohurish islame.

Kur'ani nuk është një libër që i shpjegon të gjitha çështjet në mënyrë të hollësishme dhe të zgjeruar. Ai është një libër i mbushur me shenja, nënkuptime dhe orientime, prej të cilave mund të nxirren shumë të vërteta. Ai është si një burim që hap para njeriut kapituj të tërë studimi dhe reflektimi. Kjo është natyra e vërtetë e Kur'anit.

Para se të filloj përkthimin, dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj te një pikë e rëndësishme.

Ajeti Kursi, i cili ndodhet në suren “El-Bekare”, vjen menjëherë pas ajeteve që trajtojnë historinë e Talutit dhe Xhalutit, të cilat i kemi përmendur dhe i kemi shpjeguar në një nga netët e mëparshme.

Pas rrëfimit të Talutit dhe Xhalutit, Kur'ani përmend filozofinë e xhihadit islam në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ النَّاسَ بَعْضَهُم بِبَعْضٍ لَفَسَدَتِ الْأَرْضُ﴾

“Dhe sikur Allahu të mos i pengonte njerëzit disa me disa të tjerë, toka do të prishej”¹, ku është ligjësuar xhihadi islam në rrugën e zhdukjes së korrupsionit nga toka.

1 Sure “El Bekare”, ajeti 251.

Historia e Talutit dhe Xhalutit përmban, gjithashtu, një shprehje që tregon atë që besimtarët i thanë njëri-tjetrit: pavarësisht numrit tonë të vogël dhe forcës së madhe të ushtrisë së Xhalutit, atij tirani gjakderdhës, dhe pavarësisht numrit të madh të tyre, nga pikëpamja e dukshme nuk duket e arsyeshme të përballemi me ta.

Por:

﴿كَمْ مِنْ فِئَةٍ قَلِيلَةٍ غَلَبَتْ فِئَةً كَثِيرَةً بِإِذْنِ اللَّهِ﴾

"Sa e sa grupe të vogla kanë triumfuar mbi grupe të mëdha me lejen e Allahut"²

Kjo është ajo që përmendet brenda historisë së Talutit dhe Xhalutit.

Pra, mbështetja tek Allahu është një element që përshkon të gjitha pjesët e kësaj historie. Ajo na mëson se një grup i vogël mund të triumfojë mbi një grup shumë më të madh, kur mbështetet tek Allahu. Mirëpo, kjo mbështetje duhet të kuptohet drejt dhe të shoqërohet me përpjekje konkrete, me shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe forcave që Allahu i ka vënë në dispozicion njeriut. Pikërisht ky parim shfaqet qartë në të gjitha etapat e kësaj historie.

Edhe profeti i asaj kohe nuk i mësonte njerëzit të mjaftoheshin vetëm me lutjen që Allahu t'i mbronte nga e keqja e Xhalutit. Përkundrazi, kur ata i kërkuan t'u caktonte

2 Sure "El Bekare", ajeti 249.

një prijës, ai u caktoi një mbret të aftë dhe të denjë, të cilin Allahu e kishte dalluar me dije të gjerë dhe me forcë fizike:

﴿زَادَهُ بَسْطَةً فِي الْعِلْمِ وَالْجِسْمِ﴾

“e kishte shtuar në dituri dhe në trup”³

Të gjitha këto janë burim mësimesh, urtësish dhe frymëzimi. Kur’ani, në tërësinë e tij, është i mbushur me simbole, hollësi, shenja dhe domethënie që duhen kuptuar, përvetësuar dhe studiuar. Për sa kohë që njeriu nuk e njeh gjuhën e Kur’anit dhe nuk krijon afërsi me të, ai nuk mund ta kuptojë dhe ta perceptojë siç duhet mesazhin e tij.

Me këtë nuk kam për qëllim vetëm njohjen e gjuhës arabe. Sa e sa njerëz e njohin arabishten, por nuk e kuptojnë gjuhën e Kur’anit. Kjo sepse gjuha e Kur’anit, përveç njohjes së arabishtes, kërkon edhe një afërsi shpirtërore dhe intelektuale me të.

Le të marrim si shembull një dijetar të urtë. Edhe pse ky shembull nuk mund të krahasohet me Kur’anin, i cili është Fjala e Allahut dhe qëndron shumë më lart se çdo fjalë njerëzore, ai na ndihmon ta kuptojmë çështjen. Për sa kohë që nuk ke afërsi me një dijetar, nuk ke dëgjuar gjatë ligjëratat e tij dhe nuk je njohur me mënyrën e të menduarit të tij, nuk mund t’i kuptosh plotësisht fjalët e tij. Ai mund të shprehë

³ Sure “El Bekare”, ajeti 247.

fjali që, në pamje të parë, duken të thjeshta, por nxënësi që ka kaluar vite duke studiuar pranë tij i sheh ato si fjalë të thella, të mbushura me kuptime dhe nënkuptime.

Kështu është edhe Kur'ani. Ai është Fjala e Allahut dhe, nga kjo pikëpamje, qëndron mbi çdo libër tjetër. Pa krijuar afërsi me Kur'anin, nuk është e mundur të kuptohen në nivelin e duhur thellësitë dhe përmbajtjet e tij. Por përmes meditimit, reflektimit të vazhdueshëm dhe lidhjes së ngushtë me të, këto kuptime të larta fillojnë të shpalosen dhe të bëhen të qarta.

Historia e Talutit, filozofia e xhihadit islam, fitorja e një grupi të vogël mbi një grup të madh, mbështetja (tevekuli) tek Allahu në të gjitha çështjet e jetës, veçanërisht përballë sfidave dhe vështirësive të mëdha që njeriu has, si dhe rrëfimi i Talutit dhe i profetit Daud në përballjen me Xhalutin, të gjitha këto përbëjnë hyrjen e nevojshme për të kuptuar më mirë mesazhin e këtij ajeti fisnik.

Tani ju ftoj t'i kushtoni vëmendje përkthimit dhe shpjegimit të tij.

﴿اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ...﴾

"Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Tij..." Kjo është parulla e Islamit; madje, është parulla e të gjitha feve hyjnore përgjatë historisë së njerëzimit, nga fillimi deri në

fund të saj. Çdo përpjekje dhe çdo mund që kanë bërë fetë dhe shkollat hyjnore ka pasur për synim realizimin e kësaj parulle. Por kjo nuk është një parullë e zbrazët. Ajo përfaqëson një shkollë të tërë mendimi, një botëkuptim dhe një mënyrë jetese që shtrihet në të gjitha dimensionet e ekzistencës njerëzore dhe në të gjitha anët e botës.

Kjo do të thotë se askush dhe asgjë të mos bëhet ortak me Allahun në adhurim; asnjë qenie, qoftë njeri, kafshë apo send i pajetë; asnjë instinkt, pasion apo dëshirë. Kjo do të thotë që njeriu të çlirohet nga çdo lloj pranga e zinxhiri, nga çdo formë robërie, poshtërimi dhe nënshtrimi, dhe të jetojë me dinjitet e krenari, duke mos e lidhur veten me asgjë tjetër përveç robërisë ndaj Allahut.

Ky është misioni i të gjitha feve hyjnore.

Pse? Cili është fryti i robërisë ndaj Allahut për njeriun?

Sistemi që ndërtohet mbi bazën e robërisë ndaj Allahut, është sistemi që përputhet plotësisht me natyrën e njeriut. I vetmi mjedis që mund ta zhvillojë këtë krijesë të quajtur “njeri”, ta bëjë të lulëzojë dhe të japë fryte, është sistemi hyjnor, sistemi i teuhidit dhe sistemi i drejtësisë islame.

Ai që e krijoi njeriun dhe e formësoi sipas natyrës së tij, Ai që njeh çdo hollësi të qenies së tij, Ai që është Krijuesi

dhe Formuesi i tij, e di më mirë se kushdo tjetër se çfarë instinktesh, prirjesh, ndjenjash, nevojash, dobësish dhe potencialesh fshihen në thellësinë e kësaj krijese.

Ai e di se njeriu, me gjithë dobësitë dhe fuqitë e tij, me mangësitë dhe aftësitë e tij, me thesaret e fshehura dhe potencialet e mëdha që mbart, nuk mund të zhvillohet, të përsoset dhe të arrijë lartësimin e tij të vërtetë veçse nën hijen e një sistemi hyjnor dhe teuhidik. Të gjitha sistemet e tjera janë të mangëta dhe nuk janë në harmoni me natyrën e tij të vërtetë.

Ne nuk ushqejmë armiqësi, urrejtje apo kundërshtim personal ndaj drejtuesve të sistemeve të tjera. Përkundrazi, ndiejmë dhembshuri për ta. Kjo ka qenë edhe gjuha e profetëve.

Profetët e Allahut, të cilët janë etërit shpirtërorë të njerëzimit dhe më të mëshirshmit ndaj tij, ua kanë shpjeguar vazhdimisht mendimtarëve, dijetarëve dhe ndërtuesve të sistemeve shoqërore se njerëzimi nuk mund të arrijë suksesin dhe shpëtimin e vërtetë përveçse nën hijen e sistemit hyjnor.

Ky është mesazhi i profetëve të Allahut; një mesazh që buron nga sinqeriteti dhe dhembshuria. Historia vetë e ka dëshmuar vërtetësinë e tij, sepse njerëzimi ka përjetuar pasojat dhe vuajtjet që sjellin sistemet e tjera.

Nuk dua të zgjatem më tej në këtë diskutim. Ata që merren me këto çështje dhe i studiojnë ato duhet të reflektojnë mbi domethënien e këtyre fjalëve dhe të nxjerrin prej tyre përfundimet e nevojshme.

Sistemet e ndryshme që shfaqen sot në botën bashkëkohore, me emra dhe forma të ndryshme, nuk kanë arritur ta çojnë njerëzimin drejt lumturisë së vërtetë. Rruga e vetme që mund t'i shërojë plagët dhe problemet e tij, është sistemi hyjnor. Njerëzimi nuk do të çlirohet nga kjo gjendje e mjerueshme, derisa të njohë dhe të jetojë nën hijen e një sistemi të bazuar në teuhid.

Në çdo rast, kjo ka qenë parulla e të gjitha feve hyjnore dhe Ajeti Kursi fillon pikërisht me këtë mesazh.

“Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij...”

Pastaj ajeti vazhdon: **“El-Hajj” – Ai është i Gjalli.**

Çdo gjë tjetër që adhurohet përveç Tij, është e vdekur. Sepse ai që një ditë nuk ka ekzistuar, pastaj ka ardhur në jetë dhe një ditë tjetër do të largohet prej saj, duke jetuar vetëm një periudhë të shkurtër ndërmjet dy mosekzistencave, çfarë lloj jete mund të quhet kjo?

Një jetë e mbushur me vështirësi, e shoqëruar nga dobësia dhe varësia; një jetë që mund të tronditet nga një sëmundje, të kufizohet nga nevoja dhe madje të pengohet

nga krijesa më të vogla. A mund të quhet kjo jetë e plotë dhe e pavarur?

Ndërsa Ai që ne e adhurojmë dhe të Cilit ia dorëzojmë drejtimin e jetës sonë, është i Gjalli i Përhershëm; Ai që ka qenë gjithmonë i Gjallë dhe do të mbetet gjithmonë i Gjallë.

Madje, Ai nuk është thjesht zotërues i jetës, por Vetë Jeta në kuptimin e saj absolut.

"El-Hajj".

"...El-Kajjum..."

Dijetarët kanë dhënë disa shpjegime për kuptimin e emrit "El-Kajjum". Ndoshta dy prej tyre janë më të përshtatshmet: i pari, se Ai është i Përhershmi, i Amshueshmi, pa fillim dhe pa fund; dhe i dyti, se Ai është Qenia prej së cilës çdo gjë merr ekzistencën dhe jetën e saj, Ai mbi të Cilin mbështetet çdo krijesë, ndërsa Vetë Ai qëndron i pavarur dhe nuk ka nevojë për asgjë tjetër.

Ky është kuptimi i "El-Kajjum".

Gdhendini në mendjet tuaja këto cilësi të Allahut që sapo përmendëm dhe më pas krahasojini ato me cilësitë e "zotave" të rremë të tokës: me sunduesit e padrejtë, uzurpatorët dhe mashtruesit, të cilët nuk kishin asnjë të

drejtë të robëronin njerëzit, por megjithatë i nënshtroan ata; të cilëve njerëzit nuk duhej t'u përuleshin, por i shndërruan në skllevër të vetvetes.

Sa i madh është dallimi midis Allahut, të Gjallit dhe të Vetëqëndrueshmit, dhe këtyre “zotave” të rremë, të cilët janë vetë të varur, të dobët dhe të pafuqishëm!

Prijësi i Besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi (*Paqja qoftë mbi të!*), iu drejtua myslimanëve të kohës së tij me këto fjalë: “Mos u bëj rob i askujt tjetër, ndërkohë që Allahu të ka krijuar të lirë”.⁴

Gjithashtu, është transmetuar se njëri prej kalifëve të hershëm të Islamit ka thënë: “I keni robëruar njerëzit, ndërkohë që nënat e tyre i kanë lindur të lirë”.

O ju “zota” të gënjeshtërt, të pushtimit dhe dobësisë! O ju që jeni vetë të lidhur me vdekjen dhe mosekzistencën! Me çfarë të drejte pretendoni pushtet mbi njerëzit? Mbi çfarë baze? Dhe përse?

Kur njeriu e largon shikimin nga pretendimet e rreme të hyjnisë dhe e drejton atë vetëm kah madhështia e Allahut, bëhet e qartë se të gjithë njerëzit janë të barabartë, me

4 “Nehxhul Belaga”, botimi i Subhi Salihut, Letra 13: Porosia e Imam Aliut drejtuar Imam Hasanit (Paqja qoftë mbi ta!).

përrjashtim të atyre që Allahu i ka veçuar me një mision të posaçëm, si profetët dhe evlijatë (të dashurit e Tij).

Por edhe ky dallim nuk është i rastësishëm apo i pakuptimtë. Allahu i ka dalluar ata për një urtësi dhe përgjegjësi të caktuar. Përtej kësaj përzgjedhjeje hyjnore, nuk mbetet asnjë epërsi thelbësore e një njeriu mbi tjetrin.

Atëherë, pse duhet që Zejdi të jetë rob i Amrit, Amri zotëri i Bekirit dhe Bekiri shërbëtor i Halidit? Përse duhet që njerëzit t'i nënshtrohen njëri-tjetrit dhe të jetojnë në robëri ndaj krijesave si vetja e tyre?

Krahasoni cilësitë e atyre që gjatë historisë i kanë robëruar njerëzit dhe vazhdojnë t'i robërojnë edhe sot me cilësitë e Allahut të Lartësuar, të Gjallit dhe të Vetëqëndrueshmit. Vetëm atëherë do të kuptoni qartë se detyra e njeriut është të adhurojë vetëm Allahun dhe të shkëpusë çdo lidhje robërie, nënshttrimi dhe varësie ndaj kujtdo e çdo gjëje tjetër përveç Tij.

Ky është mesazhi i teuhidit dhe thelbi i thirrjes së të gjitha feve hyjnore.

..﴿الْحَيُّ الْقَيُّومُ﴾..

"i Gjalli, nga i Cili qëndron dhe ekziston çdo gjë".

﴿لَا تَأْخُذْهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ﴾

“Nuk e zë as dremitja e as gjumi...”

Mos e konsideroni Atë të pavëmendshëm dhe mos mendoni se Ai fle. Dijetarët e kohëve tona kanë zbuluar — gjë të cilën e ka theksuar edhe Imami ynë, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në një transmetim të përcjellë më shumë se trembëdhjetë shekuj më parë — se çdo qenie e gjallë ka nevojë për gjumë dhe se nuk ka asnjë krijesë të gjallë që të mos flejë. Kjo është ajo që përmban transmetimi dhe që, sipas tyre, është vërtetuar edhe nga vëzhgimet dhe eksperimentet shkencore. Çdo qenie e gjallë, në një formë ose në një tjetër, nuk mund t’i shpëtojë gjumit. Disa flenë çdo ditë, të tjera në periudha më të gjata kohore; secila sipas natyrës së saj. Në fund, çdo qenie që gëzon jetën, përjeton edhe gjumin.

Por mos e përfshini Allahun në mesin e të gjallëve që kanë nevojë për gjumë. Ai që ka nevojë për gjumë, nuk mund të jetë i denjë për adhurim absolut. Përkundrazi, bëhuni robër të Atij që nuk e kap as dremitja dhe as gjumi, Atij që nuk e zë as përgjumja dhe as pavëmendja.

“Nuk e zë as dremitja”, domethënë as përgjumja dhe as gjumi i lehtë, **“dhe as gjumi”,** pra, as gjumi i thellë dhe i rëndë.

Këto janë disa prej cilësive të Tij.

Për sa i përket sundimit dhe zotërimit të Tij:

﴿لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ﴾

“Atij i përket gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë”.

Çdo gjë që ekziston në univers, në qiej dhe në këtë tokë ku jetojmë, i përket Atij. Çdo krijesë kthehet tek Allahu si pronë e Tij, nga njëra anë dhe si pjesë e sundimit dhe pushtetit të Tij, nga ana tjetër. Këtë gjë e lexojmë në Duanë e Iftitahut: “...dhe askush nuk mund ta kundërshtojë urdhrin e Tij”.

Prandaj, nëse Allahu e vendos dikë në një pozitë të caktuar dhe u thotë robërve të Tij: **“Dëgjojeni fjalën e tij, ndiqeni dhe bindjuni atij”**, atëherë bindja ndaj tij bëhet detyrim. Kjo sepse autoriteti i tij buron nga autoriteti i Allahut.

Përndryshe, ai është autoritet i rremë (tagut).

Çdokush që pretendon autoritet dhe pushtet, pa qenë i caktuar dhe i autorizuar nga Allahu, hyn në kategorinë e autoritete të rreme (tagutit).

Autoritet i rremë (tagut) është ai që ngrihet përballë Allahut, që nxit kryengritje, devijim, tejkalim të kufijve dhe

padrejtësi; ose ai që vetë mishëron këto cilësi dhe i udhëheq të tjerët drejt tyre.

Prandaj, kur Kur'ani shpall se Allahut i përket gjithçka që është në qiej dhe në tokë, ai njëkohësisht rrëzon çdo pretendim të rremë për sundim dhe zotërim absolut. Sundimi i vërtetë i takon vetëm Allahut, ndërsa çdo autoritet tjetër fiton legjitimitet vetëm nëse buron prej Tij dhe vepron në përputhje me urdhrin e Tij.

﴿لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ﴾

“Atij i përket gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që është në tokë”, çdo gjë në këtë hapësirë të pafund qiellore dhe çdo gjë në tokë i përket Allahut dhe është nën pushtetin e fuqisë së Tij.

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ﴾

“E kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij?”. Profetët e mëdhenj të Allahut, evlijatë (të dashurit e Tij), madje edhe dëshmorët dhe njerëzit e drejtë, do të ndërmjetësojnë në Ditën e Kiametit. Në këtë çështje nuk ka asnjë dyshim.

Mes jush që jeni të pranishëm këtu, ka prej atyre që e kanë pranuar pa hezitim parimin e shefatit (ndërmjetësimi). Ka edhe të tjerë që, për shkak të kujdesit

të tyre intelektual, kërkojnë argumente dhe prova për çështje të tilla dhe ndoshta ende kanë pyetje rreth saj.

Një ditë, në këtë xhami, kam folur për ndërmjetësimin (shegatin) dhe kam paraqitur argumentet kur'anore dhe arsyetimet që e vërtetojnë atë. Prandaj, nuk ka asnjë pengesë në pranimin e ndërmjetësimit të profetëve dhe të njerëzve të zgjedhur nga Allahu.

Megjithatë, ndërmjetësimi (shefati) në Ditën e Kiametit nuk duhet kuptuar sipas modelit të ndërmjetësimeve që ndodhin në administratat apo institucionet e kësaj bote. Ai nuk është një favorizim i padrejtë dhe as një ndërhyrje e ngjashme me ato që njohim në jetën e përditshme. Përkundrazi, ai është një realitet i një natyre krejt tjetër, me ligje dhe kuptime që i përkasin botës së amshuar.

Për ta kuptuar më lehtë, mund ta krahasojmë me lutjen dhe duanë. Ashtu siç njeriu lutet për një të gjallë ose për një të vdekur dhe i drejtohet Allahut duke thënë: "O Zot, fale filanin dhe mëshiroje atë", edhe ndërmjetësimi (shefati) është një formë e veçantë e kërimit të mëshirës hyjnore, por që realizohet në Ditën e Kiametit dhe sipas rregullave të asaj bote.

Megjithatë, kjo pozitë nuk do t' u jepet të gjithëve. Ajo është një privilegj që Allahu ua jep vetëm atyre që Ai dëshiron dhe me të cilët është i kënaqur.

Në Ditën e Kiametit, çdo njeri do të jetë i zënë me gjendjen e vet:

﴿لِكُلِّ امْرِئٍ مِنْهُمْ يَوْمَئِذٍ شَأْنٌ يُغْنِيهِ﴾

“Secili njeri prej tyre atë ditë do të ketë një çështje që e mjafton dhe e angazhon plotësisht”.⁵

Përveç profetëve dhe evlijave (të dashurve të Allahut), të cilëve u jepet kjo pozitë e veçantë, edhe dëshmorët, të drejtët, dijetarët e vetëdijshëm, udhëheqësit dhe udhërrëfyesit e njerëzimit, si dhe ata që kanë lënë gjurmë të mëdha në shërbim të së mirës dhe kanë qenë ndër robërit e singertë e të devotshëm të Allahut, mund të bëhen shkak ndihme dhe ndërmjetësimi për të tjerët.

Kur’ani flet qartë për këtë realitet. Mirëpo, mendjet tona, për shkak të kufizimeve që kanë, jo gjithmonë arrijnë t’i kuptojnë plotësisht të gjitha dimensionet e fjalës hyjnore. Për këtë arsye, askush nuk duhet të nxitojë në gjykim, duke e mohuar menjëherë ndërmjetësimin (shegatin), duke e hedhur poshtë ose duke i dhënë atij interpretime të gabuara.

Jo. Ndërmjetësimi (shefati) është një e vërtetë e miratuar.

Profetët dhe evlijatë ndërmjetësojnë, por ndërmjetësimi i tyre nuk është i pavarur. Askush nuk mund

⁵ Sure “Abese”, ajeti 37.

të ndërmjetësojë pa lejen e Allahut. Sundimi dhe autoriteti i Tij përfshin gjithçka, deri në atë masë, saqë edhe robërve më të mirë të Tij nuk u lejohet të ndërmjetësojnë për askënd, pa lejen dhe urdhrin e Tij.

Prandaj, ndërmjetësimi (shefati) nuk është një çështje që varet nga dëshira apo prirja personale e dikujt. Ai ndodh vetëm brenda kufijve të vullnetit hyjnor dhe në përputhje me urtësinë, drejtësinë dhe mëshirën e Allahut.

Ky është kuptimi i fjalës së Allahut: **"E kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pa lejen e Tij?"**

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ﴾

Çdo pjesë e këtyre ajeteve mishëron fuqinë absolute dhe mbizotëruese të Allahut, dhe çdo fjalë e tyre hap një derë drejt një deti njohurish islame, për atë që thellohet dhe mediton. Përndryshe, unë nuk bëj gjë tjetër veçse përkthimin e tyre.

﴿يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ﴾

"Ai e di atë që është përpara tyre dhe atë që është pas tyre".

Ata që qëndrojnë në frontet e kundërshtimit ndaj Allahut, ata që luftojnë teuhidin dhe ata që gjatë gjithë jetës së tyre përpiqen, me çdo mjet dhe çdo fuqi që kanë, të

pengojnë rrugën e profetëve, nuk duhet të mendojnë se Allahu është si kundërshtarët e tjerë, të cilët mund të mashtrohen, të befasohen ose të goditen përmes intrigave dhe kompleteve të fshehta.

Nëse kundërshtari yt është Allahu dhe ti je ngritur kundër Tij, atëherë duhet të presësh pasojat e pashmangshme të kësaj përballjeje, kushdo që të jesh.

Pse?

Sepse Allahu është i Gjithëdijsmi. Ai e di atë që është përpara tyre dhe atë që është pas tyre. Asnjë plan nuk i mbetet i fshehur, asnjë komplot nuk shpëton nga dija e Tij dhe asnjë veprim nuk del jashtë vëzhgimit të Tij.

Ai është i informuar për çdo mendim që lind në zemër, për çdo qëllim që formohet në mendje, për çdo hap që hidhet dhe për çdo rrugë që ndiqet. Asgjë nuk i shpëton dijes së Tij.

Prandaj, ai që ngrihet kundër Allahut dhe kundër së vërtetës, nuk përballlet me një fuqi që mund të mashtrohet ose të mposhtet nga dinakëria. Ai përballlet me Atë, dijes së të Cilit nuk i fshihet asgjë në qiej e në tokë.

﴿يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ﴾

“Ai e di atë që është përpara tyre dhe atë që është pas tyre”, domethënë, Ai e përfshin plotësisht ekzistencën e tyre.

﴿وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ﴾

“Dhe ata nuk mund të përfshijnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai dëshiron”, domethënë, njerëzit nuk mund të kuptojnë dhe nuk mund të perceptojnë nga dija e Allahut, përveç asaj që Ai vetë ua ka vënë përpara. Kjo është një tjetër shenjë e fuqisë së Allahut.

﴿وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ﴾

“Kursia e Tij përfshin qiejt dhe tokën”.

Kursia e Allahut nënkupton fuqinë, autoritetin dhe sundimin e Tij. Me fjalë të tjera, pushteti i Tij shtrihet mbi mbarë universin dhe mbizotëron mbi çdo gjë që ekziston. Sundimi i Tij ka përfshirë qiejt dhe tokën, dhe asgjë nuk del jashtë sferës së fuqisë dhe zotërimit të Tij.

Dijetarët kanë dhënë shpjegime të ndryshme për kuptimin e fjalës “Kursi”. Interpretimi që sapo përmenda, është njëri prej tyre dhe, sipas mendimit tim, është ndër më të përshtatshmit për kontekstin e këtij ajeti. Megjithatë, janë paraqitur edhe kuptime të tjera, të cilat kanë vendin e tyre në literaturën e komentimit kur’anor.

Në çdo rast, mesazhi i përgjithshëm mbetet i qartë: fuqia, sundimi dhe autoriteti i Allahut përfshijnë të gjithë ekzistencën dhe asgjë në qiej apo në tokë nuk qëndron jashtë pushtetit të Tij.

﴿وَلَا يُوَدُّهُ حِفْظُهُمَا﴾

“Dhe ruajtja e tyre nuk i shkakton lodhje”, domethënë, nuk e rëndon dhe nuk e lodh ruajtja e qiejve dhe e tokës.

﴿وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ﴾

“Dhe Ai është i Larti, Madhështori” - këto janë prej cilësive të Allahut.

Një natë, në këtë vend, kam folur për suren “El-Ihlas” dhe kam paraqitur një shpjegim të saj. E njëjta qasje vlen edhe për këtë ajet. Atëherë thashë se kjo sure rrëzon çdo pretendim dhe çdo keqkuptim që mund të ekzistojë në shoqëritë e devijuara rreth çështjes së adhurimit, qoftë në mendje apo në zemër.

Kjo sure nuk synon të japë një përkufizim të plotë të Allahut. Siç e shihni, ajo nuk merret me esencën e Tij. Ajo e paraqet Allahun si Një, si të Vetmin dhe të Pavarurin nga çdo gjë; Atë që as nuk ka lindur dhe as nuk është lindur, dhe që nuk ka askënd të barabartë apo të ngjashëm me Të. Megjithatë, ajo nuk hyn në diskutime rreth realitetit të qenies së Tij apo mënyrës së ekzistencës së Tij.

Kjo është metoda që na mëson Islami.

Në suren "El-Ihlas", Allahu paraqitet përmes cilësive të Tij, cilësi që mund ta udhëzojnë njeriun, t'i japin atij mësim dhe ta orientojnë drejt njohjes së drejtë.

E njëjta gjë ndodh edhe në Ajetin Kursi. Kur ky ajet flet për Allahun, ai përqendrohet te cilësitë e Tij. Por nuk merret me ato diskutime abstrakte që nuk sjellin dobi për jetën e njeriut dhe që nuk bëjnë gjë tjetër veçse e mbushin mendjen me terma dhe përkufizime pa ndikim praktik.

Fatkeqësisht, kjo ka qenë rruga që kanë ndjekur shumë teologë dhe mendimtarë racionalistë gjatë historisë islame. Në shumë raste, ata janë përfshirë në debate që nuk kanë sjellë ndonjë dobi të drejtpërdrejtë për jetën e shoqërisë dhe për problemet reale të njerëzve.

Natyrisht, kjo gjendje nuk u krijua rastësisht. Ajo ishte, në një masë të madhe, rezultat i politikave të ndjekura nga sundimtarët e dinastive umejade dhe abaside. Në periudhën e Beni Umejes kjo dukuri ishte më e kufizuar, ndërsa në kohën e Beni Abasit mori përmasa shumë më të gjera.

Pushtetet politike, të cilat ushqeheshin nga interesat dhe epshet e tyre, përpiqeshin të kontrollonin mendjet, gjuhët dhe zemrat e njerëzve. Qëllimi i tyre ishte që shoqëria islame të mos zgjohej, të mos dëgjonte mesazhin e pastër të

Islamit dhe të mos e kuptonte teuhidin në formën e tij të vërtetë. Sepse, po ta kuptonte atë, nuk do të mund të qëndronte indiferente përballë figurave si Mensuri, Haruni, Muavija apo Abdul-Meliku.

Për t'i mbajtur njerëzit larg problemeve të tyre reale dhe larg njohjes së të vërtetave islame, ata i angazhuan në debate të pafundme dhe shpesh pa dobi praktike. Një prej tyre ishte polemika rreth pyetjes, nëse Kur'ani është i krijuar apo i pakrijuar; nëse është hadith (i krijuar në kohë) apo kadim (i përhershëm dhe i pakrijuar).

Po ta mendosh me kujdes, kupton se sa pak ndikim ka një debat i tillë në jetën e përditshme të njerëzve. Megjithatë, për vite të tëra, teologët islamë u përfshinë në këto polemika, shpesh nën nxitjen dhe mbështetjen e kalifëve.

Një kalif vinte në pushtet dhe mbështeste njërën palë, duke shtypur mendimin kundërshtar në xhami, tubime, shtëpi, hytbe të xhumasë dhe në çdo hapësirë publike. Më pas vinte një kalif tjetër, i cili e shihte se parulla e mëparshme e kishte humbur efektin, ndaj mbështeste palën tjetër, duke i dhënë asaj pushtet dhe hapësirë për të shtypur kundërshtarët e saj. Kështu vazhdonte cikli, herë pas here, nga njëra palë te tjetra.

Për vite, madje për shekuj të tërë, mendimi islam u mbajt i ngurtësuar dhe u mbulua me perde debatesh sterile

e të pafrytshme. Pasojat e atij ngurtësimi vazhdojnë të ndihen edhe sot.

Ne dhe ju ende përballemi me gjurmët dhe pasojat e asaj trashëgimie intelektuale, e cila shpesh e largoi vëmendjen e myslimanëve nga mesazhi jetësor, shoqëror dhe transformues i Kur'anit.

*Islami është i lartë dhe nuk ka asgjë mbi të*⁶, Megjithatë, sot e shohim botën islame të robëruar nga një grusht armiqsh të Allahut, ndërsa myslimanët gjenden në një gjendje dobësie dhe përuljeje përballë kundërshtarëve të Islamit.

Bota e sotme është, në masë të madhe, një botë e sundimit të autoritetit të rremë (tabutit).

Pse ndodh kjo?

A nuk është Islami feja për të cilën Allahu ka premtuar fitoren, nderin dhe epërsinë? A nuk ka shpallur Allahu të vërtetën të qarta lidhur me fuqinë dhe triumfin e së vërtetës?

Atëherë, pse shohim një realitet kaq të ndryshëm? Pse, pavarësisht këtyre premtimeve, myslimanët kanë rënë

6 Thënie e Profetit të Madhërisëm (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), "*Nehxhul Fesaha*".

në dobësi, ndërsa forcat e padrejtësisë dhe të devijimit kanë fituar ndikim dhe pushtet?

Kjo është një pyetje që kërkon reflektim të thellë dhe një kuptim të drejtë të mësimave të Islamit.

A nuk është thënë për Islamin në Fjalën e Allahut:

﴿لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ﴾

“Që ta bëjë atë të triumfojë mbi të gjitha fetë”? A nuk erdhi Islami pikërisht për ta realizuar këtë qëllim?

Atëherë, pse mendimi islam dhe vetë myslimanët janë në këtë gjendje prapambetjeje? Pse shoqëritë myslimane janë ndër më të goditurat nga dobësia, përçarja dhe varësia? Pse plagët e tyre duken ndër më të vështirat për t’u shëruar dhe problemet e tyre ndër më të ndërlikuarat për t’u zgjidhur?

Këto janë pyetje që kërkojnë përgjigje serioze dhe reflektim të thellë.

Një poet mysliman, duke iu drejtuar Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), shprehet me keqardhje:

7 Sure “Et Teube”, ajeti 33; Sure “El Fet’h”, ajeti 28; Sure “Es Saff”, ajeti 9.

"O Ali, ngrihu! Sepse pothuajse çdo i robëruar ka arritur t'i thyejë zinxhirët e skllavërisë së tij, përveç ndjekësve dhe shi'itëve të tu."

Kjo thënie, pavarësisht gjuhës poetike që përdor, synon të shprehë një realitet të hidhur: se ata që pretendojnë ndjekjen e shkollës së lirisë, drejtësisë dhe dinjitetit, nuk duhet të mbeten të nënshtruar, të varur dhe të paaftë për të çliruar veten nga format e ndryshme të robërisë dhe pushtimit".⁸

Pse kanë marrë gjërat këtë drejtim?

Ne ende po vuajmë pasojat e hidhura të shekujve të tërë të ngurtësimit intelektual, të ndalimit dhe të mbylljes së mendimit. Sepse një pengesë sjell pas vetes pengesa të tjera dhe një devijim hap rrugën për devijime të reja.

Nëse dëshiron ta bësh dikë dembel, mjafton ta lësh për një kohë të jetojë në mesin e dembelëve; kur të largohet prej tyre, ai vetë do ta ketë përvetësuar atë gjendje.

Kështu ndodhi edhe me mendimin islam. Guri i parë u vendos shtrembër dhe, si pasojë, muri u ngrit i shtrembër. Kështu ka qenë për një kohë të gjatë dhe, në shumë aspekte, vazhdon të jetë edhe sot.

8 E poetit iranian Ni'met Mirza Zade.

Sunduesit dhe strategët e politikës, për t'i larguar njerëzit nga rrugët e drejta dhe nga çështjet themelore të jetës së tyre, janë përpjekur vazhdimisht t'i mbajnë të zënë me gjëra dytësore. Herë i kanë zhytur në shqetësimet e jetesës materiale, herë në pasionet dhe instinktet shtazarake, e herë në polemika dhe dallime të kota intelektuale, të cilat nuk mbështeten mbi asnjë bazë të shëndoshë dhe nuk sjellin asnjë dobi reale.

Ndërsa Kur'ani nuk ka ardhur për ta mbushur mendjen e njeriut me debate të tilla sterile dhe polemika boshe. Ai nuk synon të përfshijë në ajetet e tij çështje që nuk kanë ndikim në udhëzimin dhe përmirësimin e jetës së njeriut.

Prandaj, gjithçka që Kur'ani përmend për Allahun e Lartësuar, nuk është tjetër veçse njohuri dhe të vërteta të dobishme, të cilat shoqëria ka nevojë t'i njohë. Janë çështje që i sjellin dobi njeriut, kur i kupton dhe i zbaton, ndërsa injorimi i tyre sjell humbje dhe dëm për individin dhe shoqërinë.

﴿اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ﴾

“Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, i Gjalli, i Përjetshmi, Mbajtësi i gjithçkaje; Atë nuk e kap as kotja dhe as gjumi...”

Lexoni me meditim, përqendrim dhe vëmendje ajetin e parë të Ajetit Kursi deri te:

"dhe Ai është i Larti, Madhështori". Pastaj ngrini kokën dhe vështroni botën përreth jush. Do të shihni se sa të zbrazëta dhe të kota janë pretendimet e idhujve të rremë dhe sa të gabuar janë ata që pretendojnë hyjni në tokë, ndërsa i lidhin, i kufizojnë dhe i robërojnë njerëzit.

Atëherë njeriu e kupton frytin e Ajetit Kurs dhe arsyen pse na është rekomanduar ta lexojmë vazhdimisht: një herë, dy herë, dhjetë herë, madje në Ditën e Arafatit, në lidhje me zotërinë e dëshmorëve, Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe njëqind herë. Atëherë bëhet e qartë pse është theksuar kaq shumë leximi i tij në namaz, pas namazit, në mëngjes dhe në mbrëmje.

Kjo ndodh sepse Ajeti Kursi mban lart flamurin e teuhidit dhe i udhëheq besimtarët në rrugën e njohjes dhe adhurimit të Allahut Një.

Na thuhet: "Pijeni këtë ilaç, që të japë efektin e tij." Por ne shpesh mjaftohemi duke e nuhatur ilaçin, duke e parë shishen e tij, ndonjëherë duke e prekur ose duke e puthur, e pastaj e vendosim në raft, pa e përdorur kurrë në të vërtetë.

O ju myslimanë që lexoni Kur'anin! Merrni nga burimi i Ajetit Kursi dhe përfitoni prej tij, sepse ai është një mësim i madh për ne.

Ky është mesazhi i ajetit të parë.

Ajeti i parë, në mënyrë të përmbledhur, demaskon të gjitha hyjnitë e rreme të tokës dhe ua heq maskën atyre që pretendojnë atë që nuk u takon. Le të dalë përpara kushdo që i zotëron këto cilësi hyjnore, që ne t'i nënshtrohemi atij. Por ju jeni njerëz si ne: ju kap gjumi dhe përgjumja; jeta juaj është e kufizuar, ashtu si edhe jeta jonë.

Madje, ekzistenca jonë nuk varet nga ekzistenca juaj. Ne kemi jetuar para jush dhe do të vazhdojmë të jetojmë edhe pas jush. Prandaj, jeta jonë nuk përmbledhet në jetën tuaj dhe as nuk mbështetet mbi të.

Ju nuk zotëroni cilësinë e El-Kajjūmit, nuk zotëroni jetën absolute dhe as ndonjë nga cilësitë e veçanta hyjnore. Sundimi juaj nuk përfshin qiejt dhe tokën; pushteti juaj nuk shtrihet mbi gjithë ekzistencën.

Prandaj, pretendimet tuaja për hyjni nuk janë veçse iluzione. Ne e refuzojmë këtë hyjni të rreme, sepse ajo nuk përputhet me kriteret që paraqet Ajeti Kursi.

Transmetohet se një burrë mysliman shkoi për të takuar perandorin e Romës në pallatin e tij. Para se të hynte, i thanë:

- Duhet të përulesh, kur të hysh!
- Pse? – pyeti ai.
- Sepse do të hysh te perandori, i cili është ulur në fronin e tij. Kushdo që hyn, duhet të përkulet para tij.
- Në këtë rast, nuk hyj dhe nuk e përcjell mesazhin tim. Kthehem andej nga kam ardhur.
- Pse?
- Sepse ne kemi ardhur për t'i çliruar njerëzit nga zakoni që e bën njeriun rob të njeriut.

Edhe poeti dhe mendimtari Muhamed Ikbali ka thënë: "Nuk kam parë kurrë një qen të ulë kokën para një qeni tjetër".

Çfarë do të thotë kjo?

Do të thotë se njeriu nuk duhet të jetë rob i askujt tjetër përveç Allahut. Të gjithë duhet të jemi robër të Allahut dhe vetëm të Allahut.

Ky është mesazhi i ajetit të parë.

Tani le të kalojmë te ajeti i dytë. Hapni Kur'anin tuaj.

﴿لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ﴾.

“Nuk ka detyrim në fe”.⁹

Ne nuk ua imponojmë njerëzve bindjet dhe mendimet tona me forcë. Megjithatë, nëse dikush përpiqet të na pengojë në përhapjen e fjalës së Kur'anit, ne do t'i kundërvihemi. Nëse një dorë ngrihet për të penguar ose goditur bartësit e mesazhit të Kur'anit, ne do ta ndalim atë. Dhe nëse dikush përpiqet të vendosë perde mes njerëzve dhe fesë së Allahut, për ta fshehur Islamin dhe Kur'anin nga sytë e tyre, ne do ta heqim atë pengesë.

Kjo ishte gjuha dhe logjika që Kur'ani kishte formuar te myslimanët e brezit të parë.

Ne veprojmë për të larguar pengesat që qëndrojnë përballë udhëzimit hyjnor, por nuk e detyrojmë askënd që të besojë. Kush e sheh të vërtetën, e kupton dhe e pranon atë, është i lirë ta përqafojë. Ndërsa ai që nuk dëshiron ta pranojë, mund të vazhdojë të jetojë në shoqërinë islame, të gëzojë sigurinë dhe të drejtat e saj, pa iu bërë padrejtësi.

Kjo është arsyeja pse hebrenjtë dhe të krishterët jetonin të qetë dhe me dinjitet në shoqërinë e ndërtuar mbi mësimet e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë

⁹ Sure “El Bekare”, ajeti 256.

mbi të e mbi familjen e tij!), mbi parimet e teuhidit dhe të drejtësisë islame.

Ndoshta e kam përmendur edhe më parë këtë ngjarje historike, por po e rikujtoj shkurtimisht.

Kur myslimanët çliruan Jerusalemin dhe qytetin e Himsit (Humsit), në vitet e para pas ndërrimit jetë të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!), ata u përballën me një situatë që tregon qartë natyrën e marrëdhënies së Islamit me popujt dhe komunitetet e tjera fetare.¹⁰

Ju e dini se kjo ngjarje nuk u drejtua as nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe as nga i Dërguari i nderuar i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!). Ajo u udhëhoq nga njerëz që ne nuk i konsiderojmë të përsosur në kuptimin e plotë; përkundrazi, disa prej tyre

10 Në kohët moderne, vendet e Shamit përfshijnë: Sirinë, Jordaninë, Libanin, Palestinën, Qipron dhe pjesë të Turqisë e Egjiptit. Kjo zonë iu bashkua qeverisjes islame në kohën e kalifit të parë. Qyteti i Himsit (Humsit), i cili aktualisht konsiderohet qyteti i tretë më i madh në Siri dhe ndodhet në pjesën perëndimore të këtij vendi, ra në duart e myslimanëve në vitin e pesëmbëdhjetë hixhri. Ndërsa Bejtul Makdisi, që konsiderohet një nga qytetet më të vjetra të botës, kibla e parë e myslimanëve dhe një nga vendet më të shenjta për hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët, u çlirua nga myslimanët në vitin e shtatëmbëdhjetë hixhri. Sot, ky qytet ndodhet në territoret e pushtuara të Palestinës, dhe entiteti sionist uzurpues e konsideron atë kryeqytetin e vet.

kishin mangësi dhe, në disa raste, edhe qëllime të diskutueshme.

Megjithatë, kur Islami hyri në atë rajon, myslimanët morën xhizjen nga banorët dhe e vendosën atë në Bejtulmal (arkën e pasurisë së shtetit).

Më vonë, kur myslimanët morën vesh se perandoria kishte përgatitur një ushtri për t'i sulmuar dhe se ata nuk mund ta mbronin më atë qytet, vendosën të tërhiqeshin.

Atëherë i mbledhën banorët dhe u thanë:

- Këto janë pasuritë tuaja që na i keni dhënë si xhizje. Ne po jua kthejmë ato.

- Ne nuk kemi parë dhe as nuk kemi dëgjuar ndonjëherë për një qeveri që merr taksa nga një popull dhe më pas ia kthen ato. Pse po veproni kështu?

- Ne e morëm këtë xhizje nga ju si një kontribut për mbrojtjen tuaj dhe për përgatitjet që nevojiteshin për t'ju ruajtur nga fuqia e padrejtë dhe shtypëse e perandorisë. Por tani, pasi nuk jemi më në gjendje t'ju mbrojmë dhe ta largojmë armikun, nuk kemi të drejtë ta mbajmë këtë pasuri. Prandaj, po jua kthejmë atë.

- Sundimi juaj dhe drejtësia juaj janë më të dashura për ne sesa ajo që kemi përjetuar më parë nga padrejtësia dhe shtypja.¹¹

Kjo ngjarje ka ndodhur në kohën e Perandorisë Romake Lindore. Banorët e asaj zone u larguan nga hyjnitë e rreme, të cilat më parë u ishin detyruar përmes sundimit dhe kontrollit, dhe e pranuan Islamin në vend të tyre.

Sa u përket hebrenjve, ata që nuk e vlerësojnë këtë mirësi, duhet të kujtojnë se gjatë gjithë periudhës islame ata nuk kanë parë nga myslimanët dhe shpatat e tyre veçse dashuri, mbrojtje dhe shërbim, ndërsa nga ana e tyre, ndaj myslimanëve, nuk ka ardhur gjithmonë veçse dëm dhe armiqësi. Ndër shembujt e përmendur në histori janë K'ab el-Ahbari, Vehb ibn Munebihi dhe Abdullah ibn Selami¹²

11 **"Futuhul Buldan"**, Ahmed ibn Jahja El Beladhuri, i cili vdiq në shekullin e tretë hixhri.

12 Fjala **"el ahbar"** përdoret për dijetarët e hebrenjve. **Ka'bul Ahbari** ishte ndër figurat kryesore të dijetarëve hebrenj dhe e përqafoi Islamin në kohën e kalifit të dytë. Përmes transmetimit të haditheve të sajua, ai vendosi themelet e sundimit të Muavijes në Sham.

Abdullah ibn Selami ishte prej dijetarëve hebrenj dhe nga fisi Hazrexh. Ai e pranoi Islamin, kur i Dërguari i Zotit hyri në Medinë. Profeti e quajti Abdullah.

Vehb ibn Munebihi lindi në kohën e kalifit të tretë. Babai i tij ishte nga dijetarët e mëdhenj të Ithtarëve të Librit dhe kishte pranuar Islamin në kohën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Pranimi i Islamit nga njerëz të tillë shkaktoi hyrjen e **israilijateve** në njohuritë islame. Me **israilijate** nënkuptohen legjendat dhe rrëfimet e transmetuara nga Teurati dhe nga burimet e shtrembëruara hebraike.

në periudhën e hershme të Islamit e deri në ditët tona dhe në çdo kohë që kanë qenë të pranishëm, kjo “degë” ka qenë vazhdimisht burim dëmi për Islamin dhe myslimanët.

Ata (hebrenjtë) gjetën në drejtësinë islame një kënaqësi dhe siguri të tillë, saqë u betuan në Teurat se nuk do t’ju braktisnin për t’iu drejtuar perandorit për mbështetje. Madje, nëse perandori do t’ju sulmonte, ata do të qëndronin në anën tuaj dhe do të luftonin kundër tij.

Kështu dëshmojnë banorët e asaj perandorie. Arsyeja ishte e qartë: ata jetonin të qetë dhe gëzonin mirëqenie nën sistemin islam, pa u detyruar ta përqaфонin botëkuptimin islam.

Në kohët kur pengesat dhe perdet e ngritura nga njerëzit nuk lejonin që fjala e së vërtetës të arrinte te mbarë bota, shpata ishte mjeti që vendoste fatin e çështjeve.

Por, kur u dallua qartë rruga e drejtë nga e shtrembëta, kur udhëzimi u veçua nga humbja dhe e vërteta u nda nga gënjeshtria, njerëzit filluan të kuptonin bukurinë dhe madhësitinë e Islamit. Ata e kuptuan se Islami është një nga mirësitë dhe begatitë më të mëdha të Allahut.

Po ashtu, ata e kuptuan se një jetë e lumtur, e begatë dhe e qëndrueshme nuk mund të ndërtohet mbi detyrimin dhe dhunën.

﴿لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ﴾

"Nuk ka detyrim në fe; është bërë e qartë rruga e drejtë nga rruga e shtrembër", dhe rruga e drejtë është dalluar nga rruga e humbjes dhe e shtrembër.

﴿فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنِ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى﴾

"Ai që mohon tagutin dhe beson në Allahun, është kapur fort pas lidhjes më të qëndrueshme."

Ne nuk këmbëngulim që njerëzit ta besojnë me detyrim në Allahun, por kjo nuk do të thotë se nuk e dëshirojmë një gjë të tillë. Profeti i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është si një baba për këtë umet dhe për mbarë njerëzimin; ai dëshiron që të gjithë të ecin në rrugën e robërisë ndaj Allahut. Megjithatë, kjo nuk arrihet me forcë dhe as me detyrim.

Njerëzit duhet ta dinë se kushdo që mohon autoritetin e rremë (tabutin), largohet nga fuqitë që mendojnë se kanë cilësi hyjnore, heq dorë nga bindja ndaj tyre dhe nga pranimi i urdhrave të tyre, dhe beson në Allah, "është kapur fort pas lidhjes më të qëndrueshme".

Ata duhet të kuptojnë se kjo është rruga e drejtë, rruga e vërtetë që e çon njeriun drejt përsosmërisë. Është rruga që, nëpër kthesat dhe vështirësitë e jetës, e merr njeriun për dore dhe e udhëheq drejt Xhenetit të lumturisë, që është synimi i fundit i çdo njeriu.

“Ai që mohon autoritetin e rremë (tagutin)” – atë që i kundërvihet Allahut dhe pretendon atë që i takon vetëm Atij – “dhe beson në Allahun, është kapur fort pas lidhjes më të qëndrueshme”, domethënë është mbështetur në një lidhje të fortë, të sigurt dhe të pathyeshme. “Ajo nuk ka shkëputje”; kjo lidhje nuk priset dhe nuk këputet kurrë. “Dhe Allahu është Dëgjues dhe i Dijshëm”; Ai dëgjon atë që thoni dhe di atë që veproni.

Por cili është dëmi i autoritetit të rremë (tagutit)? Pse duhet të shkëputemi prej tij dhe të lidhemi me Zotin? Problemi i autoritetit të rremë (tagutit) është se ai e nxjerr njeriun nga drita në errësirë. Ai krijon një botë të errët, një zemër të errët, një varr të errët dhe një botë tjetër të mbuluar nga errësira. Ai errëson shpirtin, mendimin, shikimin dhe tërë ekzistencën e njeriut. Si pasojë, njeriu jeton në një jetë të mbushur me terr, mjerim, shqetësim dhe fatkeqësi. Ky është thelbi i dëmit që sjell autoritetit të rremë (taguti).

Ndërsa Zoti është krejt e kundërta e kësaj. Ai i largon errësirat nga ekzistenca e njeriut, madje edhe ato materiale. Ai e largon varfërinë dhe sjell begati e mirëqenie. Kështu vepron sistemi islam: çrrënjës paditurinë dhe dhuron

kulturë të lartë e fisnike; zhduk përçarjen, armiqësinë, urrejtjen, grindjen dhe hipokrizinë, dhe në vend të tyre mbjell dashurinë, vëllazërinë, qetësinë dhe paqen e brendshme. Ai e shndërron garën mes njerëzve në një garë për vepra të mira, në vend që ta lërë të bëhet rivalitet dhe përplasje kundër njëri-tjetrit.

Në transmetimet që flasin për fundin e kohëve dhe për vendosjen e qeverisjes së vërtetë hyjnore, thuhet se një njeri e pyeti Imamin: "Çfarë do të bëjnë njerëzit atë ditë?" Në thelb, ai po pyeste se këto energji dhe aftësi të mëdha që Allahu ka vendosur në qenien e njeriut, në çfarë do të orientohen atëherë? Imami u përgjigj: "Ata do të garojnë në vepra të mira".

Kështu është Zoti:

﴿اللَّهُ وَلِيُّ الَّذِينَ آمَنُوا﴾

"Allahu është mbrojtësi i atyre që besuan."¹³ Ata e kanë shpjeguar fjalën *veli* me kuptimin "mik" dhe "i dashur", por ky është një shpjegim i gabuar. Ne kemi thënë shpesh se qëllimi i fjalës **"Allahu është Veli"** është se Allahu është drejtues dhe ruajtës.

Po të donim ta shpjegojmë më saktë, do të thoshim: shoqërues dhe përkrahës. Ky është kuptimi i *veliut*. **"Allahu është Veliu i atyre që besuan"** do të thotë: Allahu i ruan ata

13 Sure "El Bekare", ajeti 257.

që kanë besuar, i drejton çështjet e tyre, qëndron në anën e tyre dhe i shoqëron.

Më pas ajeti thotë:

﴿يُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ﴾

“Ai i nxjerr ata nga errësirat në dritë”: I nxjerr nga errësirat e paditurisë, fatkeqësisë dhe epsheve, dhe i çon drejt dritës; dritës së udhëzimit, dritës së besimit, dritës së një shoqërie të ndërtuar e të lirë, dritës së virtyteve morale dhe, në fund, dritës së njerëzisë.

Por,

﴿وَالَّذِينَ كَفَرُوا﴾

“ata që mohuan”, që e refuzuan Zotin dhe iu bashkuan frontit të autoritetit të rremë (tagutit),

﴿أُولَٰئِكَ هُمُ الطَّاغُوتُ﴾

“mbrojtësit e tyre janë autoriteti i rremë (taguti)”; domethënë autoriteti i rremë (taguti) është ai që i udhëheq, i drejton çështjet e tyre, i ruan, mban në dorë frerët e punëve të tyre dhe është ai që urdhëron e ndalon mes tyre.

Po tjetër çfarë bëjnë me ta tiranët, mbrojtësit e tyre? Për këtë Kur’ani thotë:

﴿يُخْرِجُوهُمْ مِّنَ النُّورِ إِلَى الظُّلُمَاتِ﴾

“I nxjerrin ata nga drita në errësira.” Por a kishin vallë ata dritë? Po, është drita e natyrshmërisë së pastër, e cila shuhet tek ata; drita e njerëzisë që fiket tek ata; xhevahiri i ndritshëm e rrezatues që u merret, pasi Zoti e kishte

vendosur në shpirtrat e tyre. Pastaj mbi ta sundojnë padituria, marrëzia dhe errësira.

Por çështja nuk ndalet me kaq, përkundrazi,

﴿أُولَئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ﴾

"ata janë banorët e zjarrit". Ata janë banorë të zjarrit në atë botë dhe edhe në këtë jetë të kësaj bote: zjarri i varfërisë, zjarri i poshtërimit dhe zjarri i përbuzjes.

Sa shumë të pasur e të kamur ka që janë të përulur, dhe sa shumë të fuqishëm e të pushtetshëm që, në të vërtetë, janë të dobët. Mos u mashtro nga pamja e tyre e jashtme dhe mos u jep rëndësi pretendimeve apo fjalëve të tyre të bujshme, sepse, në thelb, ata janë robër të përulur, të vegjël dhe pa vlerë.

Për ta ruajtur atë fasadë të jashtme, ata detyrohen të kryejnë padrejtësi e krime; detyrohen të grabisin, të shtypin dhe të cenojnë të drejtat e të tjerëve. Prandaj, ata janë robër të epsheve të tyre dhe shpesh edhe robër të atyre që i mbajnë nën sundim. Në të vërtetë, ata janë njerëz të poshtëruar dhe pa personalitet.

Këto janë zjarret e jetës së kësaj bote. Pas tyre vjen zjarri i zemërimit hyjnor në botën tjetër, një zjarr që nuk ka kufi e as fund, dhe banorët e të cilit do të përballen me një vuajtje të pandërprerë.

﴿هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ﴾

“do të jenë aty përgjithmonë”

Mund t’ju lindë kjo pyetje: Si mund të thuhet se Allahu është Veliu dhe Ndihmuesi i besimtarëve, kur Ai nuk i ndihmoi ata në Kerbela, në kryengritjen e Zejd ibn Aliut dhe në raste të tjera të ngjashme? Nëse Allahu ishte me ta, përse nuk i dha fitoren?

Ky keqkuptim lind nga mendimi se ndihma ndaj një fronti realizohet vetëm duke asgjësuar armiqtë e tij dhe duke prerë kokat e kundërshtarëve. Por kjo nuk është e vërtetë. Ndihma e vërtetë ndaj një fronti qëndron në mbijetesën dhe përjetësimin e tij, edhe nëse individët që e përbëjnë atë largohen dhe zëvendësohen nga të tjerë.

Çdo front që ka një mision, një vizion dhe një synim për të ndikuar në botë, nuk mund të bëhet i përjetshëm veçse nëpërmjet përjetësisë së mendimit të tij. Sa e sa njerëz kanë bartur ide dhe vizione të mëdha, por vetë ata kanë vdekur dhe janë larguar nga kjo botë.

A mund të thuhet se çështja e Profetit Musa mori fund me vdekjen e tij? Sigurisht që jo. Feja e Musait vazhdoi të jetojë; po ashtu mbeti feja e Ibrahimit dhe mbetën edhe shumë tradita të tjera fetare.

Këtu nuk po flasim për dallimin mes së vërtetës dhe së pavërtetës, sepse edhe e pavërteta ndjek të njëjtin ligj historik. Një grup mbetet gjallë për aq kohë sa mbetet fronti i tij, ndërsa fronti mbetet gjallë për aq kohë sa mbetet mendimi i tij. Nëse mendimi vazhdon të jetojë, nëse vizioni triumfon dhe historia gjykon në favor të tij, atëherë ai front nuk është shkatërruar, nuk është mposhtur dhe nuk është zhdukur, edhe nëse bartësit e tij janë larguar nga kjo jetë.

Madje, ndonjëherë njerëzit e një ideali e vulosin vizionin e tyre dhe mesazhin që përfaqësojnë me diçka që nuk shuhet e nuk harrohet lehtë: me gjakun e tyre. Gjaku bëhet firma e përjetësisë së një çështjeje. Kështu veproi Hysen ibn Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili e vulosi me gjakun e tij misionin dhe qëllimin e vet, që ai të mos shpërbëhej dhe të mos humbiste në rrjedhën e historisë.

Këtë të vërtetë e kanë kuptuar mirë edhe mendimtarët e kohëve moderne. Ata thonë se çdo ide dhe çdo vizion që vulolet me gjak, fiton jetëgjatësi dhe mbetet i gjallë në kujtesën e historisë. Prandaj shohim se shumë prej ideve që kanë mbijetuar ndër shekuj, janë pikërisht ato për të cilat ndjekësit e tyre kanë sakrifikuar gjithçka.

Mbi këtë bazë, Hysen ibn Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) është fitimtari i vërtetë. Allahu ishte me të dhe e ndihmoi atë, sepse mesazhi i tij mbeti i gjallë, ndërsa sakrifica e tij vazhdon të frymëzojë breza të tërë.

O Zoti ynë! Të përgjërohemi për hir të Muhamedit dhe familjes së Muhamedit që të na shtosh njohjen për pozitën e sakrifikuesve dhe të luftëtarëve në rrugën Tëndë!

O Zoti ynë! Për hir të Muhamedit dhe familjes së Muhamedit, na afro pranë Muhamedit dhe familjes së tij dhe na bëj që ta njohim gjithnjë e më mirë rrugën, metodën, jetën dhe moralin e tyre.

O Zoti ynë! Për hir të Muhamedit dhe familjes së Muhamedit, na jep një jetë si ndjekës të Hysen ibn Aliut dhe na bëj të vdesim si ndjekës të tij.

O Zoti ynë! Për hir të Muhamedit dhe familjes së Muhamedit, bëje zemrën e bekuar të Veliut të Kohës të jetë e kënaqur me ne. Na cakto të gjithëve një pjesë të madhe nga ajo që kemi thënë dhe nga ajo që kemi dëgjuar.

Allahu e mëshiroftë atë që lexon suren “El-Fatiha”.

إسم الكتاب: شرح وتفسير آية الكرسي

المؤلف: الإمام الخامنئي (رضوان الله عليه)

الاعداد: صهبا

المترجم: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: يريما كولا

التصحيح اللغوى: إسراء مريا

الإخراج النهائي: صربيه فزا

الغلاف: صربيه فزا

الناشر: جمعية النسيم

تيرانا- البانيا- 2026